



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1180/3 Prot.

Tiranë, më 28 / 09 / 2018

### V E N D I M

Nr. 185, datë 28 / 09 / 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 146, datë 17.09.2018, e R.M kundër KMCA<sup>1</sup> Epror në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjuhës”, “bindjes filozofike”, “gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore, familjare, shëndetësore”, “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, në Janar 2017 i kanë ndërprerë pagesën e paaftësisë në qytetin e Sarandës dhe e kanë informuar se duhet të drejtohet KMCA<sup>1</sup> në Tiranë. Në datë 07.06.2017 është paraqitur në KMCA<sup>1</sup> Epror<sup>2</sup>. Në muajin Tetor i ka ardhur përgjigjja që nuk e ka rifituar pagesën e paaftësisë. Ankuesja informon se që prej muajit Janar 2017 është pa të ardhura me bashkëshortin invalid dhe me dy fëmijë për të rritur.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri që t'i rikthehet e drejta e përfitimit të pagesës së paaftësisë.

#### II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,

<sup>1</sup> Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.

<sup>2</sup> Vendimi KMCA<sup>1</sup> Epror nr.874, datë 07.06.2017, R.M pa grup, nuk përfiton pagesë paaftësie.

*vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

**Lidhur me pretendimet e R.M, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni është i formës së prerë. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: *“Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”*.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, t’i drejtoheni Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për të kundërshtuar vendimin e KMCAP-s Epror që nuk është i formës përfundimtare.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32/1, germa a), nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, dhe 10, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës së R.M, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**